



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

Në bazë të nenit 102, nenit 105 paragrafi 2 pika 2.5 të LPP-së, nenit 28 të Udhëzimit Operativ për Prokurim Publik të KRPP-së, dhe nenit 10 pika 6 të Rregullorës së Punës së OSHP-së, Bordi i OSHP-së, duke e parë neglizhencën e zyrtarëve të prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese, për mosvazhdimin e validitetit të tenderëve, me rastin e skadimit të afatit të tyre, me datën : **25.11.2014 mori këtë :**

## V E N D I M

**Mbi njohjen me obligimin ligjor të zyrtarëve të prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese, për zbatimin e nenit 28.4 të Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik të KRPP-së**

1. Detyrohen të gjithë zyrtarët e prokurimit publik të Autoriteteve Kontraktuese, që ta zbatojnë përpikërisht Udhëzimin Operativ të Prokurimit Publik të KRPP-së, përkatësisht nenin 28.4 të këtij udhëzimi, në të cilin kërkohet që **AK, duhet të kërkojë prej operatorëve ekonomik zgjatjen e afatit të validitetit të tenderëve, kur atyre ju afrohet data skadimit të tyre, për një ose arsye të ndryshme.**
2. Në rast se zyrtarët e prokurimit nuk veprojnë konformë nenit 28.4 të UOPP-së, atëherë autoriteti kontraktues, nuk mund të bëjë anulimin e tenderit për shkak të skadimit të validitetit të ofertave dhe skadimit të sigurimit të tenderit, por janë të obliguar që rishtas të iu dërgojnë kërkesën për vazhdim të validitetit të ofertave dhe të tenderit të gjithë operatorëve ekonomik pjesëmarrës që kanë interes material në aktivitetet përkatës të prokurimit. Sepse nuk mund të pësojnë dëme operatorët ekonomik, për faj dhe neglizhencë të autoriteteve kontraktuese. Anulimi i tenderëve me pretekst të skadimit të validitetit të ofertave që fatkeqësisht ka filluar të bëhet praktik nga disa autoritete kontraktuese dhe është në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit në prokurimin publik.
3. Për çdo neglizhim të këtyre dispozitave, të Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik të KRPP-së, si dhe të këtij vendimi, Panelet Shqyrtuese të OSHP-së, do të ndër marrin masa rigoroze ndaj Autoriteteve Kontraktuese dhe zyrtarëve të prokurimit të AK, konformë nenit 25 pika 8 dhe nenit 131 të LPP-së.

4. Një obligimi të tillë, zyrtarët e prokurimit, nuk mund t'i ikin, as atëherë kur lënda gjendet në shqyrtim pranë OSHP-së, sepse AK, i kanë shënimet e operatorëve konkurrues në evidencën e tyre, ose të dhënat për to mundin t'i marrin edhe në OSHP.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëher - nga dita e marrjes së të njëjtit.
6. Lidhur me zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën anëtarët e bordit të OSHP-së, zyrtarët e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese si dhe Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së.

**Të njoftohen :**

- Zyrtarët e prokurimit të AK - ve;
- Anëtarët e bordit të OSHP – së;
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;
- Agjencia Qendrore e Prokurimit
- Arkiva e OSHP-së.

25.11.2014  
Prishtinë

